

Titulli i lëndës: Letërsi gjermane: Baroku deri te Iluminizmi

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Titulli i lëndës:	Letërsi gjermane: Baroku deri te Iluminizmi
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i II-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në këtë lëndë, studentët do të njoftohen me letërsinë gjermane, të shekullit të 17 e një pjese të shek. 18, ose më saktë duke përfshirë Iluminizmin (Aufklärung). Studentët do të mësojnë për periudha të rëndësishme letrare e kulturore të cilat derguan njerëzimin drejt ndryshimeve të mëdha sociale e 33kulturore, pas lindjes së Kohës së Re. Njoftohen me periudhat e shek. 17, për reformat në letërsi të cilat i sollli me vete ky shekull dhe periudha e Barokut. Nuk mund të kapërcehen pa u përmendur figura të njohura për letërsinë e kësaj periudhe si Martin Opici, Andreas Gryfius e Hans Jakob von Grimmelshausen. Dhe e fundit, Iluminizmi- periudha veprat e së cilës kishin cak ndriqimin e mendjes dhe ngritjen e vetëdijes së shoqërisë borgjeze në një shoqëri monarkiste absolutiste. Studentët mësojnë për zhanret kryesore letrare të këtyre periudhave: drama e humanizmit, drama e barokut, soneti, krijimi i tragjedisë borgjeze, etj.</p>

Qëllimet e lëndës:

- Lënda Letërsi gjermane: Baroku deri te Iluminizmi ka për objektiv t'i njohë studentët me letërsinë gjermane të këtyre periudhave të rëndësishme letrare, kulturore e historike, si: Baroku e me theks të veçantë Iluminizmi
- Njohja e studentëve me autorët dhe veprat më të rëndësishme të kohës
- Studentët mësojnë për zhanret kryesore letrare të këtyre periudhave: drama e humanizmit, drama e barokut, soneti, krijimi i tragjedisë borgjeze, etj.
- Kjo lëndë ka për qëllim t'i mësojë studentët të analizojnë dhe interpretojnë veprat letrare

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të sukseshem të këtij kursi (lënde) studenti do të:

- Kenë njohuritë themelore për letërsinë gjermane të Barokut dhe me theks të veçantë Iluminizmit;
- dijë karakteristikat kryesore të periudhave, prapaskenën historike të zhvillimit të tyre, llojet kryesore letrare
- dijë për autorët dhe veprat më të rëndësishme të kohës, zhvillimin e zhanreve letrare
- jetë në gjendje të shkruaj një seminar të shkurtër rreth një teme të caktuar nga letërsia;
- të zhvillojë debat me kolegët e tij rreth një teme nga letërsia;
- të jenë në gjendje t'i zbatojnë njohuritë e përvetësuara gjatë punës së tyre të pavarur për analizë të letërsisë

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin	10min	6	1
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	8	3	24
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			151:25= 6.04 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies do të jetë me studentin në qendër dhe interaktive. Realizimi i programit nga lënda <i>Letërsi gjermane</i> Baroku deri te Aufklärung bëhet edhe me pjesëmarrjen aktive të vet studentëve, të cilët qysh në fillim të semestrit të parë pasi ju dorëzohet programi përcaktohen për një temë për të cilën do të referojnë me ç'rast do të mësojnë edhe për punën e pavarur për mbledhjen e seleksionimin e materialit të nevojshëm për hartimin e një punimi. Të gjithë studentët punojnë nga një seminar për një temë të cilën ata vet e zgjedhin nga planprogrami. Gjatë orëve të ushtimeve pastaj, lexohen seminarët ose referohen dhe për to dhe zhvillohet debat në klasë për temën dhe periudhën letrare të cilës i takon. Kështu, pjesëmarrja aktive e studentëve bëhet komponentë qenësore në arritjen e objektivave të lëndës dhe arritjen e rezultateve të pritshme.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%; Provimi final 70%.</p> <p>Në këtë lëndë studentët notohen edhe për seminarët që punojnë gjatë vitit. Duke qenë se gjatë orëve referohet për seminarët dhe diskutohet në klasë për periudhën letrare të cilës i takon vepra e poashtu për autorin, krijimtarinë e jetën e tij dhe posaqërisht për veprën në fjalë, të gjitha këto</p>

	<p>vlërësohen me notë e kjo pastaj mblidhet me notën e provimit përfundimtar që mbahet pas përfundimit të semestrit të III</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjëratat të përgatitura nga prof. ass. dr. Albulena Blakaj-Gashi 2. Blakaj, Albulena: Letërsia gjermane nga Iluminizmi deri te Romantizmi, Pjesa I. Bard Books, Prishtinë, 2025. 3. Meid, Volker: Reclam Buch der Deutschen Literatur, Philipp Reclam jun. Verlag Stuttgart, 2004 4. Baumann/ Oberle, Deutsche Literatur in Epochen, Max Hueber Verlag, Ismaning, 2000 5. Beutin, Wolfgang ua.: Deutsche Literaturgeschichte: von den Anfängen bis zur Gegenwart. Metzler, 9., erweiterte Auflage 2019 6. Meid, Volker: Barocklyrik, 2. Auflage, Metzler 2008 7. Kühlmann, Wilhelm: Martin Opitz. Deutsche Literatur und deutsche Nation. Heidelberg 2001. 8. Der abenteuerliche Simplicissimus Deutsch. Aus dem Deutschen des 17. Jahrhunderts und mit einem Nachwort von Reinhard Kaiser. Eichborn AG, Frankfurt am Main 2009 9. Lessing, Gotthold Ephraim: Nathan der Weise, Klett, 2007 10. Lessing, Gotthold Ephraim: Emilia Galotti, Suhrkamp Verlag, 2004
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Die deutsche Literatur in text und Darstellung - Barok</i>, Philipp Reclam jun. Verlag Stuttgart - v. Wilpert, <i>Sachwörterbuch der Literatur</i>, Alfred Kröner Verlag, Stuttgart, 2002 - <i>Der abenteuerliche Simplicissimus Deutsch</i>. Aus dem Deutschen des 17. Jahrhunderts und mit einem Nachwort von Reinhard Kaiser. Eichborn AG, Frankfurt am Main 2009 - <i>Lessing, Gotthold Ephraim: Nathan der Weise</i>, Klett, 2007 - <i>Lessing, Gotthold Ephraim: Emilia Galotti</i>, Suhrkamp Verlag, 2004
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Einführung in die Literatur des 17. und 18. Jahrhunderts
Java 2:	Wiederholung: Deutsche Literatur des Humanismus, Renaissance und Reformation

Java 3:	Deutsche Literatur des Barocks
Java 4:	Martin Opitz ("Poetologie")
Java 5:	Andreas Gryphius ("Es ist alles Eitel")
Java 6:	Grimmelshausen (Roman "Simplicissimus")
Java 7:	Aufklärung
Java 8:	Philosophie der Aufklärung: Immanuel Kant und die deutsche Aufklärung
Java 9:	Gottsched, Johan Christoph: "Versuch einer kritischen Dichtkunst vor den Deutschen"
Java 10:	Lessing, Gotthold Ephraim, Das Leben und Werk
Java 11:	Lessings theoretische Werk "Laokoon" und "Fabeln"
Java 12:	Lessing: "Miss Sara Sampson"
Java 13:	Lessing: "Emilia Galoti"
Java 14:	Lessing: "Nathan der Weise"
Java 15:	Wiederholung

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.